



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

DREJTORIA E KOORDINIMIT TË SKS, PËRAFRIMIT DHE PROJEKTEVE
Sektori i Koordinimit dhe Planifikimit Strategjik

Raporti 4-mujor i monitorimit të Programit të Statistikave Zyrtare¹ (Janar-Prill, 2026)

¹ Ky raport hartohet në zbatim të Nenit 17, pika 5 të Ligjit nr. 17/2018 “Për Statistikat Zyrtare”. Në mbështetje në nenit 17, pika 5 e Ligjit nr. 17/2018 “Për statistikat zyrtare”, Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT ka përgjegjësinë për t’i paraqitur Këshillit të Statistikave raporte të shkurtra 4-mujore për ecurinë e zbatimit të Programit të Statistikave Zyrtare.

INSTAT - Instituti i Statistikave

Tel+(355) 4 2222411
+(355) 4 2233356
Fax+(355) 4 2228300

Rr. Vllazën Huta, Nd. 35, H. 1, Nj.A. Nr.2, 1017,
Tiranë, Shqipëri

info@instat.gov.al

Tabela e përmbajtjes

HYRJE.....	3
Kuadri strategjik.....	4
Ecuria e aktiviteve statistikore.....	5
Fusha statistikore 1: Statistikat Demografike dhe Sociale.....	5
Fusha statistikore 2: Statistikat Ekonomike	7
Fusha statistikore 3: Statistikat Sektoriale	8
Fusha statistikore 4: Statistikat e Mjedisit dhe Multidomain.....	10
Censet	12
Menaxhimi i Cilësisë.....	13
Aktivitete të tjera	14

HYRJE

Programi i Statistikave Zyrtare është dokumenti bazë që parashikon prodhimin e statistikave zyrtare nga Sistemi Kombëtar Statistikor të nevojshme për vëzhgimin e gjendjes ekonomike, shoqërore dhe mjedisore në Republikën e Shqipërisë. Monitorimi i ecurisë së programit është element shumë i rëndësishëm për garantimin e plotësimit të aktiviteteve statistikore të parashikuara në të.

Ligji nr. 17/2018 “Për Statistikat Zyrtare” parashikon si një ndër instrumentet monitoruese raportimin periodik me bazë 4-mujore.

Raporti 4 - mujor mbi zbatimin e Programit të Statistikave Zyrtare (PSZ) për periudhën Janar-Prill, 2026, është përgatitur në bashkëpunim me agjencitë e tjera statistikore, të cilat kanë dhënë informacion për modulet statistikore nën përgjegjësinë e tyre sipas programit. Ky raport i referohet zbatimit të Planit Vjetor të PSZ për vitin 2026, miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë me vendim nr. 28/2026, datë 20.02.2026 “Për miratimin e Planit Vjetor 2026 për zbatimin e Programit të Statistikave Zyrtare 2022-2026”.

Raportet 4 - mujore për zbatimin e PSZ janë dokumentet bazë, të cilat paraqiten nga Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT për Këshillin e Statistikave dhe shërbejnë për hartimin e Raportit Vjetor, i cili i paraqitet Kuvendit të Shqipërisë.

Raporti përmban në strukturën e tij një informacion të shkurtër mbi:

- Kuadrin Strategjik
- Ecurinë e aktiviteteve statistikore
- Censet
- Menaxhimin e Cilësisë

Progres raporti Janar-Prill, 2026

Gjatë periudhës Janar-Prill, 2026, agjencitë statistikore të Sistemit Kombëtar Statistikor: INSTAT, Banka e Shqipërisë Ministria e Financave dhe Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore janë angazhuar për realizimin e aktiviteteve statistikore që kanë nën përgjegjësi sipas Planit Vjetor 2026 për zbatimin e Programit të Statistikave Zyrtare 2022 - 2026.

Kuadri strategjik

Strategjia e zhvillimit të Sistemit Kombëtar Statistikor është pjesë integrale e Programit të Statistikave Zyrtare 2022 – 2026. Planit Vjetor për zbatimin e PSZ-së parashikon edhe aktivitetet për arritjen e objektivave strategjikë. Objektivat janë shoqëruar me treguesit respektivë të performancës.

Në tabelën e mëposhtme paraqiten vlerat e treguesve të matshëm në nivel 4 mujor, për periudhën Janar-Prill, 2026.

Tabela 1. Ecuria 4 mujore e treguesve strategjikë Janar-Prill, 2026

Objektivi	Treguesi	Vlera Shtator-Dhjetor 2025	Vlera Janar-Prill, 2026	Vlera sipas Planit Vjetor 2026
Objektivi strategjik 1: Zhvillimi i SKS për të përmbushur plotësisht acquis communautaire lidhur me statistikat dhe të mbështesë plotësisht procesin e integritetit Evropian	Numri i akteve të reja ligjore të përafuara me acquis (Sipas PKIE)	2	0	2
Objektivi strategjik 2: Plotësimi i nivelit të plotë të kërkesave të përdoruesit për statistika zyrtare	Numri i aktiviteteve statistikore të disagreguara në nivel qarku dhe bashkie	4	1	21
	Numri i vizitave në faqen e internetit të INSTAT-it	897,000	947,676	3,535,000
Objektivi strategjik 3: Prodhimi i statistikave zyrtare të një niveli të lartë cilësie, që të përputhen me standardet e pranuar Evropiane dhe ndërkombëtare	Numri i raporteve të cilësisë të publikuara	14	22	64

Objektivi strategjik 4: Përfshirja e institucioneve shtesë prodhues në Programin Kombëtar të Statistikave Zyrtare	Numri i institucioneve furnizuese me të dhëna administrative mikro	2	3	4
	Numri i temave të trajnimeve të organizuara nga INSTAT	2	1	5
Objektivi strategjik 6: Rritja e besimit të publikut në SKS dhe njohja e tij si strukturë institucionesh me performancë të duhur dhe profesionalisht të pavarur	Numri i referimeve ndaj produkteve të SKS-së në media, p.sh., në gazetatat kryesore ose në televizione	6,874	6,313	32,000

Ecuria e aktiviteteve statistikore

Në Planin e PSZ 2026, për periudhën Janar-Prill, 2026, është parashikuar:

- Grumbullimi i të dhënave për 105 Produkte - Grumbulluar në kohë 103 produkte
- Përpunimi i të dhënave për 101 produkte - Përpunuar në kohë 100 produkte
- Publikimi i të dhënave për 61 produkte - Realizuar në kohë 60 publikime

Gjatë kësaj periudhe parashikohet realizimi i 44 aktivitete statistikore për publikimin e 61 produkteve statistikore.

Ndarja e aktiviteteve dhe produkteve statistikore sipas agjencive statistikore rezulton të jetë:

INSTAT: 33 aktivitete statistikore - planifikuar publikimi i 42 produkteve statistikore statistikore - realizuar në kohë 42 produkte.

Banka e Shqipërisë: 8 aktivitete statistikore - planifikuar publikimi i 16 produkteve statistikore - realizuar në kohë sipas Planit.

Ministria e Financave: 2 aktivitete statistikore - planifikuar publikimi i 2 produkteve statistikore- realizuar në kohë sipas Planit.

Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore: 1 aktivitet statistikor - planifikuar publikimi i 1 produkti statistikor – Nuk është publikuar në kohë.

Për 4-mujorin referencë, rezulton që plani është realizuar në masën 98% në fazën e grumbullimit, 99 % në fazën e përpunimit, 98% në fazën e publikimit.

Në vijim paraqitet në mënyrë të detajuar ecuria e realizimit të aktiviteteve statistikore për secilën fushë statistikore sipas 3 fazave: grumbullim, përpunim dhe publikim.

Fusha statistikore 1: Statistikat Demografike dhe Sociale

Statistikat sociale përfshijnë statistikën e popullsisë, tregut të punës dhe pagave, arsimit, shëndetësisë, të ardhurave dhe shpenzimeve të konsumit, mbrojtjes sociale, drejtësisë dhe krimit, kulturës, si dhe përdorimit të kohës.

Objektivi kryesor i statistikave sociale është që të sigurojë të dhëna në kohë dhe me cilësi të lartë të treguesve statistikorë, të cilët ndihmojnë në hartimin e politikave sociale dhe ekonomike me qëllimin final të zhvillimit dhe përmirësimit të mirëqënies shoqërore, si dhe në monitorimin e impaktit të këtyre politikave në aspektet e ndryshme të jetës në vend.

Agjencia statistikore përgjegjëse është INSTAT.

Tabela 2. Zbatimi i Planit sipas 3 fazave të prodhimit statistikor

	Planifikuar	Realizuar në kohë	Jo në kohë
Grumbullim	13	13	
Përpunim	8	8	
Publikim	8	8	

1. Faza e grumbullimit të të dhënave

Për periudhën Janar-Prill, 2026, janë grumbulluar të dhënat në kohë për 13 produkte statistikore:

- Për 4 produkte të dhënat janë grumbulluar me anë të vrojtimit: 2 CAPI; 1 CATI; 1 PAPI.
- Për 8 produkte të dhënat janë marrë nga burimet administrative: 1 Mikro; 5 Makro; 2 Kombinuar (Makro+Mikro).
- Për 1 produkt të dhënat janë marrë nga burime të kombinuara (Vrojtim + Burim Administrativ) dhe të dhënat janë të Kombinuara (Mikro + Makro).

2. Faza e përpunimit të të dhënave


Për periudhën Janar-Prill, 2026, janë përpunuar të dhënat në kohë për 8 produkte statistikore.

3. Faza e publikimit të të dhënave

Për periudhën Janar-Prill, 2026, janë publikuar të dhënat në kohë për 8 produkte statistikore:

- Për 1 publikim të dhënat janë në nivel qarku
- Për 7 publikime të dhënat janë në nivel kombëtar

Figura 1. Ecuria e tre fazave (grumbullim, përpunim, publikim)



Fusha statistikore 2: Statistikat Ekonomike

Statistikat ekonomike përfshijnë statistikat makroekonomike, statistikat financiare të qeverisë, fiskale dhe sektorit publik dhe statistikat e biznesit, të cilat luajnë një rol të rëndësishëm në hartimin e politikave ekonomike dhe përbëjnë bazën kryesore të informacionit për analiza të mëtejshme mbi zhvillimin dhe ndryshimet strukturore të ekonomisë së vendit.

Objektivi kryesor i statistikave ekonomike është që të sigurojnë të dhëna në kohë dhe me cilësi të lartë të treguesve statistikorë, të cilët ndihmojnë në hartimin e politikave ekonomike, si dhe në monitorimin dhe menaxhimin e këtyre fushave.

Agjencitë statistikore përgjegjëse janë INSTAT, Banka e Shqipërisë dhe Ministria e Financave.

Tabela 3. Zbatimi i Planit sipas 3 fazave të prodhimit statistikor

	Planifikuar	Realizuar në kohë	Jo në kohë
Grumbullim	18	17	1
Përpunim	17	17	
Publikim	11	11	

1. Faza e grumbullimit të të dhënave

Për periudhën Janar-Prill, 2026, janë grumbulluar të dhënat në kohë për 17 produkte statistikore:

- Për 2 produkte të dhënat janë grumbulluar me anë të vrojtimit: 2 CAPI.
- Për 3 produkte të dhënat janë marrë nga burimet administrative dhe janë të nivelit Makro.
- Për 8 produkte të dhënat janë marrë nga burime të kombinuara (Vrojtim+Burim Administrativ): 2 Mikro; 6 Kombinuar (Mikro + Makro).
- Për 4 produkte të dhënat janë marrë nga burime si: Burim administrativ + Regjistër. Të dhënat janë të kombinuara (Mikro + Makro).

Nuk u grumbulluan të dhënat në kohë për “Statistikat mbi lejet e ndërtimit të miratuara në Republikën e Shqipërisë, T4, 2025” për shkak të mungesës së raportimit nga bashkia Durrës dhe Gramsh.


2. Faza e përpunimit të të dhënave

Për periudhën Janar-Prill, 2026, janë përpunuar të dhënat në kohë për 17 produkte statistikore.

3. Faza e publikimit të të dhënave

Për periudhën Janar-Prill, 2026, janë publikuar të dhënat në kohë për 11 produkte statistikore, dhe të dhënat janë në nivel kombëtar.

Figura 2. Ecuria e tre fazave (grumbullim, përpunim, publikim)



Gjatë periudhës Janar-Prill, 2026, për fushën e Statistikave Ekonomike janë transmetuar në Eurostat të dhënat për 5 produkte statistikore.

*INSTAT në bashkëpunim të ngushtë me Bankën e Shqipërisë mundësoi transmetimin për herë të parë për publikim të statistikave të qeverisë dhe tabelave të njoftimit të procedurës së deficitit të tejkaluar. Të dhënat u transmetuan më 30 Prill 2026 me seri kohore 2010-2025.

Fusha statistikore 3: Statistikat Sektoriale

Statistikat sektoriale përfshijnë një sërë fushash heterogjene si: statistikat e bujqësisë, peshkimit dhe pyjeve, statistikat e energjisë, transportit, turizmit, statistikat mbi tregtinë e jashtme dhe bilancin e pagesave, statistikat e çmimeve, shkencës dhe teknologjisë, inovacionit.

Objektivi kryesor i statistikave sektoriale është që të sigurojnë të dhëna në kohë me cilësi të lartë të treguesve statistikore, të cilët ndihmojnë në hartimin e politikave të përbashkëta mbi fushat e sipërpërmendura si dhe në monitorimin dhe menaxhimin e tyre.

Agjencitë statistikore përgjegjëse janë INSTAT, Banka e Shqipërisë dhe Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore.

Tabela 4. Zbatimi i Planit sipas 3 fazave të prodhimit statistikor

	Planifikuar	Realizuar në kohë	Jo në kohë
Grumbullim	71	70	1
Përpunim	71	70	1
Publikim	40	39	1

1. Faza e grumbullimit të të dhënave

Për periudhën Janar-Prill, 2026, janë grumbulluar të dhënat në kohë për 70 produkte statistikore:

- Për 39 produkte të dhënat janë grumbulluar me anë të vrojtimit: 17 PAPI; 22 CAPI.
- Për 18 produkte të dhënat janë marrë nga burimet administrative: 15 Makro; 3 kombinuar (Mikro+Makro);
- Për 7 produkte të dhënat janë marrë nga burime të kombinuara dhe janë të nivelit Mikro.
- Për 6 produkte të dhënat janë marrë nga burime si: Vrojt看 + Burim Administrativ + regjistër) dhe të dhënat janë të kombinuara (Mikro+Makro).

Nuk u grumbulluan të dhënat në kohë për *statistikat e energjisë me frekuencë 3-mujore* për shkak të mosmarrjes së të dhënave në kohë nga Bankers Petroleum.

2. Faza e përpunimit të të dhënave

Për periudhën Janar-Prill, 2026, janë përpunuar të dhënat në kohë për 70 produkte statistikore.

Vonesë në grumbullimin e të dhënave për *statistikat e energjisë me frekuencë 3-mujore* solli vonesa në fazën e përpunimit.


3. Faza e publikimit të të dhënave

Për periudhën Janar-Prill, 2026, janë publikuar të dhënat në kohë për 39 produkte statistikore:

- Për 5 publikime të dhënat janë në nivel rajoni
- Për 34 publikime të dhënat janë në nivel kombëtar

Si pasojë e mos realizimit të dy fazave të mësipërme, nuk u realizua as publikimi i *statistikave e energjisë me frekuencë 3-mujore*.

Figura 3. Ecuria e tre fazave (grumbullim, përpunim, publikim)



Gjatë periudhës Janar-Prill, 2026, për fushën e Statistikave Sektoriale janë transmetuar në Eurostat të dhënat për 30 produkte statistikore.

Fusha statistikore 4: Statistikat e Mjedisit dhe Multidomain

Statistikat e mjedisit dhe multidomain përfshijnë statistikën e mjedisit dhe statistikën rajonale dhe gjeohapësinore.

Qëllimi kryesor i statistikave të Mjedisit dhe Multidomain është sigurimi i të dhënave në kohë dhe me cilësi të lartë të treguesve statistikore, të cilët ndihmojnë në hartimin e politikave të përbashkëta mjedisore dhe socio-ekonomike, monitorimin dhe menaxhimin e këtyre fushave si dhe integrimin e informacionit statistikor dhe atij gjeohapsinor, me anë të të cilit synohet sigurimi i numrit më të madh të mundshëm të statistikave të gjeoreferuara në kohë dhe cilësi nga fusha të ndryshme të statistikave në një nivel territorial të detajuar.

Agjencia statistikore përgjegjëse është INSTAT.

Tabela 5. Zbatimi i Planit sipas 3 fazave të prodhimit statistikor

	Planifikuar	Realizuar në kohë	Jo në kohë
Grumbullim	3	3	
Përpunim	3	3	
Publikim	2	2	

1. Faza e grumbullimit të të dhënave

Për periudhën Janar-Prill, 2026, janë grumbulluar të dhënat në kohë për 3 produkte statistikore:

- Për 3 produkte të dhënat janë marrë nga burimet administrative dhe të dhënat janë të nivelit Mikro.

2. Faza e përpunimit të të dhënave


Për periudhën Janar-Prill, 2026, janë përpunuar të dhënat në kohë për 3 produkte statistikore.

3. Faza e publikimit të të dhënave

Për periudhën Janar-Prill, 2026, janë publikuar të dhënat në kohë për 2 produkte statistikore:

- Për 2 publikime të dhënat janë në nivel kombëtar

Figura 4. Ecuria e tre fazave (grumbullim, përpunim, publikim)



Gjatë periudhës Janar-Prill, 2026, për fushën e Statistikave të Mjedisit dhe Multidomain janë transmetuar në Eurostat të dhënat për 2 produkte statistikore.

▪ Aktivitetet mbi Informacionin Statistikor rajonal dhe Gjeohapësinor

Aktivitetet e realizuara të GIS për periudhën Shtator-Dhjetor, 2025, janë si më poshtë :

- *Sistemi i Informacionit Gjeografik (GIS) për qëllime Statistikore:*
 - Pasurimi i WEBGIS me indikatorët e Cens 2001 dhe publikimi i tyre - Gjithsej 46 indikatorë (në nivel qarku dhe bashkie);
 - Përgatitja e indikatorëve të popullsisë në nivel grid 1km2 sipas metadatave INSPIRE;
 - Publikimi në WEBGIS i treguesve të Censit 2023 në nivel grid: Popullsia Totale (TOT_POP), Popullsia sipas Gjinisë (Meshkuj dhe Femra).
- *Ndërtimi i Regjistrit statistikor të ndërtesave dhe banesave të Shqipërisë:*
 - Testime të vazhdueshme të aplikacionit mobile data collection si dhe atij web app për përmirësime të mëtejshme;
 - Modifikime dhe testime të Rregullave të Cilësisë:

- Përgatitja në shqip e Katalogut të Variablave për të tre entitetet;
- Trajnim lidhur me përdorimin e *Dashboard Administration* (për punën në terren - parapërgatitjet si (email, template format, etj);
- Misione dhe përgatitje për fazën përmbyllëse të Regjistrat - konsolidimi dhe mirëmbajtja.
- *Klasifikimi statistikor i njësive territoriale:*
- Është përcaktuar klasifikimi DEGURBA - Shkalla e Urbanizimit - duke përllogaritur apo përditësuar listën e qyteteve;
- Sipas klasifikimit DEGURBA, rajonet ndahen në: 1) Rajone kryesisht urbane, 2) Rajone të ndërmjetme, si dhe 3) Rajone kryesisht rurale;
- Është përcaktuar tipologjia urban-rural, tipologjia bregdetare në nivel rajonal (NUTS 3) si dhe zonat bregdetare në nivel lokal (LAU) sipas metodologjive dhe rekomandimeve të EUROSTAT.
- *Harmonizimi i temave "Demografia" dhe "Njësitë Statistike" sipas direktivës INSPIRE:*
Në bashkëpunim me Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG) janë standartizuar, plotësuar metadatat dhe janë gati për publikim në gjeoportalin e GIS-it Kombëtar të ASIG temat njësitë statistikore, shpërndarja e popullsisë sipas Njësive të Qeverisjes Vendore dhe në nivel rrjet qelizore (grid) 1km² si dhe ndërtesat Cens 2023 për qëllime banimi.

▪ **Censi i Popullsisë dhe Banesave 2023**

Gjatë periudhës Janar-Prill, 2026, janë realizuar aktivitetet si vijojnë:

- Në vijim të aktiviteteve pas Censit të Popullsisë dhe Banesave 2023 dhe në funksion të përafrimit të plotë me rekomandimet e Eurostat, u publikuan rivlerësimet vjetore të popullsisë për periudhën 2012-2023;
- U finalizuan vlerësimet e projeksioneve të popullsisë bazuar në analizën e të dhënave të Censit 2023, nëpërmjet përditësimit të hipotezave sipas varianteve (i ulët, mesëm dhe i lartë) të komponentëve bazë (lindje, vdekje dhe migracion), mbështetur në trendet e tyre ndër vite.

▪ **Censi i Bujqësisë**

Gjatë periudhës Janar-Prill, 2026, janë realizuar aktivitetet si vijojnë:

- Organizimi i misionit më 19-23 Janar 2026, me ekspertin e huaj mbi *Frame-in*, Pyetësin dhe Pragjet që do të përdoren në Censin e Bujqësisë;
- Përditësimi i pyetësit duke u bazuar në diskutimet gjatë misionit dhe rekomandimet e lëna nga ekspertja në raportin e misionit;
- Organizimi i punës për përmbylljen e detyrave të lëna nga ekspertja në raportin e misionit;
- Përgatitja e kontrolleve logjike për aplikacionin CAPI;
- Punë mbështetëse për përgatitjen e Frame për Censin e Bujqësisë;
- Rishikimi i Udhëzuesit për Anketuesit dhe Kontrollorët;

- Organizimi i takimit me përfaqësues të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, më 30.03.2026, ku u bë prezantimi i draft-pyetëtorit të Censit të Bujqësisë dhe pragjeve;
- Diskutime në misionin e organizuar më 23-27 Mars 2026, me ekspertin e huaj mbi përcaktimin e kontrolleve hard dhe soft në variablat e pyetëtorit të Cens-it të Bujqësisë;
- Vazhdimi i punës për përllogaritjen e vlerave për vendosjen e kontrolleve soft dhe hard, si dhe përcaktimin e vlerave minimale dhe maksimale për variablat e pyetëtorit;
- Kryerja e disa testimeve të programit CAPI.

Menaxhimi i Cilësisë

Gjatë periudhës Janar-Prill, 2026, vlerat e treguesve të cilësisë janë reflektuar në tabelat sipas fushave statistikore si më poshtë:

Tabela 6. Statistikat Sociale dhe Demografike: Treguesit e Cilësisë

Aktivitetet	Pritshmëritë 2026	Janar-Prill, 2026
Dokumentimi sipas standardit GSBPM	18	0
Matja e kostos së aktiviteteve statistikore	18	0
Auditi Statistikor	0	0
Pyetëtori i vetëvlerësimit	1	0
Raportet e cilësisë/metadatit sipas fushave	22	4
Raportet e cilësisë/metadatit sipas fushave të reja	1	0

Tabela 7. Statistikat Ekonomike: Treguesit e Cilësisë

Aktivitetet	Pritshmëritë 2026	Janar-Prill, 2026
Dokumentimi sipas standardit GSBPM	17	0
Matja e kostos së aktiviteteve statistikore	17	0
Auditi Statistikor	0	0
Pyetëtori i vetëvlerësimit	1	0
Raportet e cilësisë/metadatit sipas fushave	17	15
Raportet e cilësisë/metadatit sipas fushave të reja	0	0

Tabela 8. Statistikat Sektoriale: Treguesit e Cilësisë

Aktivitetet	Pritshmëritë 2026	Janar-Prill, 2026
Dokumentimi sipas standardit GSBPM	24	0

Matja e kostos së aktiviteve statistikore	24	0
Auditi Statistikor	2	0
Pyetësi i vetëvlerësimit	0	0
Raportet e cilësisë/metadatat sipas fushave	18	3
Raportet e cilësisë/metadatat sipas fushave të reja	0	0

Tabela 9. Statistikat e Mjedisit dhe Multidomain: Treguesit e Cilësisë

Aktivitetet	Pritshmëritë 2026	Janar-Prill, 2026
Dokumentimi sipas standardit GSBPM	4	0
Matja e kostos së aktiviteve statistikore	4	0
Auditi Statistikor	0	0
Pyetësi i vetëvlerësimit	0	0
Raportet e cilësisë/metadatat sipas fushave	7	0
Raportet e cilësisë/metadatat sipas fushave të reja		0

Aktivitete të tjera

Konferenca e MICS 2026

Më 7 Janar 2026 filloi trajnimi i 80 anketuesve dhe kontrollorëve të MICS Shqipëri 2026 – Anketa e Grupimit të Treguesve të Shumëfishtë. Roli i tyre është thelbësor: çdo intervistë dhe çdo pyetje e bërë me kujdes kontribuon në krijimin e një baze cilësore të të dhënave.

MICS, si një bashkëpunim midis INSTAT dhe UNICEF Albania, do të forcojë më tej angazhimin për transparencë, të dhëna të besueshme dhe vendimmarrje të informuar për të ardhmen e fëmijëve dhe familjeve shqiptare.

Takime me media

INSTAT zhvilloi gjatë muajit Shkurt dhe fillimit të muajit Maj takime informuese me përfaqësues të medias, me qëllim forcimin e komunikimit institucional dhe rritjen e transparencës mbi informacionin statistikor të publikuar.

Gjatë këtyre takimeve, gazetarët u njohën me ndryshimet më të fundit metodologjike të aplikuara në publikimet e INSTAT, veçanërisht në lidhje me Indeksin e Çmimeve të Konsumit (IÇK) dhe Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit (IHÇK). U prezantuan elementët kryesorë të metodologjisë, ndryshimet në përlllogaritje dhe rëndësia e harmonizimit me standardet ndërkombëtare statistikore.

Takimet shërbyen gjithashtu si një hapësirë bashkëbisedimi me median, ku gazetarët ndanë nevojat dhe vështirësitë e hasura gjatë interpretimit dhe përdorimit të informacionit statistikor. Diskutimet u fokusuan në mënyrat për të përmirësuar aksesin, kuptueshmërinë dhe komunikimin e të dhënave

statistikore për publikun e gjerë. Nëpërmjet këtyre aktiviteteve, INSTAT synon të forcojë bashkëpunimin me median dhe të kontribuojë në rritjen e cilësisë së raportimit të bazuar në statistika zyrtare.

Treguesit e Shkencës dhe Teknologjisë në Bujqësi (ASTI)

Gjatë datave 11–12 Mars 2026, Instituti i Statistikave (INSTAT) organizoi një workshop, ku prezantoi dhe diskutoi raportet pilot të vendit për Treguesit e Shkencës dhe Teknologjisë në Bujqësi (ASTI), duke përfshirë gjetjet kryesore dhe mësimet e nxjerra nga pilotimi, si dhe rekomandimet për zbatimin në nivel global.

Programi ASTI ka shërbyer prej kohësh si një referencë globale për matjen e investimeve dhe burimeve njerëzore në sistemet e kërkimit bujqësor, duke ofruar evidenca thelbësore për hartimin e politikave dhe orientimin e investimeve strategjike në bujqësi. Ndërkohë që FAO vijon me mbledhjen e të dhënave ASTI dhe integrimin e tyre në platformën FAOSTAT, forcimi i kapaciteteve statistikore kombëtare dhe garantimi i prodhimit të qëndrueshëm të të dhënave mbeten prioritet kryesor.

Ky aktivitet mblodhi së bashku aktorë kombëtarë dhe vëzhgues ndërkombëtarë për të diskutuar hapat e ardhshëm drejt institucionalizimit të prodhimit të të dhënave ASTI në Shqipëri dhe në vendet e tyre përkatëse. Forcimi i bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të përfshira në prodhimin dhe përdorimin e të dhënave do të jetë thelbësor për të siguruar raportim të rregullt dhe për të rritur përdorimin e evidencës në zhvillimin e politikave bujqësore. INSTAT mbetet i përkushtuar për të mbështetur prodhimin e statistikave zyrtare me cilësi të lartë dhe për të kontribuar në iniciativa statistikore ndërkombëtare që mbështesin zhvillimin e qëndrueshëm.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Lantona Sado

